REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 6124 Prot

Maliq, më 21.10.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 6, datë 21.10. 2026

PËR
"Disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë", i ndryshuar"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* i ndryshuar,

PROPOZOJ:

I. Të miratoj disa ndryshime në strukturën organizative të Bashkisë Maliq si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", pozicioni i punës *"**Nëpunës taksash (kontratë) Libonik***", pranë Sektorit të Kontrollit të Tatimpaguesve në Territor, të ndryshohet dhe të bëhet: "***Nëpunës Inspektor Tatimor Libonik***", Klasa "VI-3", me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55.000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

2- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Mirëmbajtje Objekte Publike*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor mirëmbajtje"***, me nr. rendor 26 në këtë drejtori, Klasa "Pika 11", paga për pozicion bëhet në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune;

II. Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

III. Për nxjerrjen e urdhrit për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 21 / 10 /2026

A. Muka Dt. 21 / 10 /2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 6174. Prot. Maliq, më 21.10.2026

RELACION

Për

"Disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë" i ndryshuar"

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Maliq

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29/1, shkronja "a", neni 54, shkronja "ç", ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 31.05.2023 *"Për klasifikimin e e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendor, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeeverisajes vendore*", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 2, datë 08.01.2026 "*Rishqyrtim i Vendimit të Këshillit të Bashkisë Maliq nr. 147, datë 24.12.2025 "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera të varësisë",* i ndryshuar,

Sipas projekt-vendimit të paraqitur, propozohet që në strukturën organizative të Bashkisë Maliq miratohen disa ndryshime si më poshtë:

1- Në strukturën e Administratës së Bashkisë Maliq (qëndër), në lidhja nr. 1 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

   - Në "*Drejtorinë e të Ardhurave*", pozicioni i punës *"**Nëpunës taksash (kontratë) Libonik***", pranë Sektorit të Kontrollit të Tatimpaguesve në Territor, të ndryshohet dhe të bëhet: "***Nëpunës Inspektor Tatimor Libonik***", Klasa "VI-3", me pagë grupi nga 10-14.000, paga për pozicion në masën **55.000** (*pesëdhjetë e pesë mijë*) lekë dhe shtesë 0.6-1% për vjetërsi në punë.

     Argumentimi : Ky ndryshim bëhet për efekt të menaxhimit të punëve në këtë drejtori. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar.

2- Në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në lidhja nr. 5 të bëhet një ndryshim si më poshtë:

- Në "*Sektorin e Mirëmbajtje Objekte Publike*", të ndryshohet paga për pozicionin e punës ***"Punëtor mirëmbajtje"***, me nr. rendor 26 në këtë drejtori, Klasa "Pika 11", paga për pozicion bëhet në masën **50.000** (*pesëdhjetë mijë*) lekë dhe shtesë 1% për vjetërsi në punë, me 8 orë pune;

  Argumentimi : Ndryshimi i pagës për këtë pozicion pune bëhet për efekt të ngarkesës së ulët që ka ky pozicion. Për këtë pozicion pune do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës

3- Efektet financiare fillojnë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Bashkisë Maliq për vitin 2026.

Në kompetencën Tuaj ligjore, përcaktuar në nenin 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", gërma (ç), të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ju paraqesim për miratim e projekt-vendimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj!

Konceptoi: N. Çaushi Dt. 21 / 10 /2026

A. Muka Dt. 21 / 10 /2026

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ